REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:193753
Datë: 31.10.2022
Numri i dokumentit: 03586571

P.nr.944/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit F.Z., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1663-8/21 të datës 27.08.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala dhe të akuzuarit, më datë 24.10.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.Z.,, nga i ati **.....** dhe nëna **.....**e lindur **.....**, i lindur me datë **.....**në fshatin **.....**, Komuna e Malishevës, tani jeton në Prizren, rruga "**.....**, nr...., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor ndërtimtarie, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Më datën 22 Qershor të vitit 2021, në Prizren, në rrugën "**.....**", saktësisht në shtëpinë e tij familjare, i pandehuri me qëllim që të përfitoj nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, gjatë kontrollës nga ana e anëtarëve të komisionit nga KEDS-i, është konstatuar se i pandehuri me anë të një kabllo është lidhë në mënyrë direkte në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse, duke e anashkaluar njehsorin elektrik me numër **.....**, ku energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast të dëmtuarës ndërmarrjes "KEDS", Distrikti në Prizren, i ka shkaktuar dëm material,

Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3, 7, 17, 38, 39 par.1 pika 1.2, 46 par.1, pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, 71,72, dhe 314 par.1 të KPRK-ës, te akuzuarit i shqipton:

2021:193754

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari ne afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër te re penale,

E dëmtuara: KEDS - Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, si dhe në emër të mbrojtjes së viktimave shumën prej 30,00 Euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II nr.1663-8/21 të datës 27.08.2021, kundër të akuzuarit F.Z.,, nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Beqë Shala, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzë PP.nr.1663-8/21 të datës 27.08.2021, kundër të akuzuarit F.Z.,, nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-ës, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari F.Z.,, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, tërë ngjarja ka ndodhur ashtu siç është përshkruar edhe në dispozitiv të aktakuzës, unë në ndërkohë me të dëmtuarën nga muaji prill i vitit 2022, kam lidhur kontratë lidhur me pagesën e borxhit paraprakë krahas borxhit të rregullt mujor të cilën e paguaj në emër të pagesës së shpenzimeve të energjisë elektrike, po ashtu deklaroj se në datën kur është parashtruar kallëzimi penal nga ana e këtu të dëmtuarës, unë nuk kam pasur mundësi ta lidhi paraprakisht kontratën e lidhur në ndërkohë, për shkak se e dëmtuara për të lidhur këtë kontratë ka kërkuar paraprakisht pagesën e gjysmës së borxhit të mbledhur në ndërkohë, për çka unë nuk kam pasur mundësi materiale ta bëjë këtë pagesë.

Në ndërkohë unë siç theksova më lart në muajin prill të këtij viti kam lidhur kontratë me të dëmtuarën, dhe nga muaji prill, dhe tani e besoj edhe në vijim paguaj në mënyrë të rregullt të gjitha shpenzimet e energjisë elektrike ashtu siç edhe e kemi theksuar edhe në kontratë, pra edhe borxhin tim paraprakë për çdo muaj paguaj nga 100 euro, deri te pagesa përfundimtare e tij, si dhe edhe borxhin e çdo muaji që më vije në emër të pagesës të shpenzimeve të energjisë elektrike për muajin paraprak.

Të gjitha të cekurat më lart, si dhe rrethanat e mija personale, që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, si dhe rrethanat e mija familjare, që jam person familjar, baba

2021:193754

i tre fëmijëve, dhe nga të ardhurat që i siguroj nga puna ime si punëtor ndërtimtarie, jam i vetmi burim i sigurimit të ekzistencës të familjes sime për momentin.,

Të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Më datën 22 Qershor të vitit 2021, në Prizren, në rrugën "**.....**", saktësisht në shtëpinë e tij familjare, i pandehuri me qëllim që të përfitoj nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, gjatë kontrollës nga ana e anëtarëve të komisionit nga KEDS-i, është konstatuar se i pandehuri me anë të një kabllo është lidhë në mënyrë direkte në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse, duke e anashkaluar njehsorin elektrik me numër **.....**, ku energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast të dëmtuarës ndërmarrjes "KEDS", Distrikti në Prizren, i ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-ës .

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 70 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i tre fëmijëve, andaj duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të të njëjtit, gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

2021:193754

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të ligjit me nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.944/2021 më datë 24.10.2022

Procesmbajtësja **Gjyqtari**
Nacis Sarani **Luan Berisha**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

2021:193754